**Vdekje fashizmit — Liri Popullit**

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguemе

# RILINDJA

*ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS*

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО: ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ
DEL DY HERE NE JAVE T'EJTEN DHE TE DJELEN

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

*PAJTIMET*
*per 1 vit 192 din*
*— 6 muej 94 —*
*— 3 muej 48 —*

Dorshkrimet nuk kthehen

*Odgovorni urednik XHELADIN*
*Drejtori pergjegjes HANA*

Vjeti IV Nr. 120 | PRISHTINE, e Ejte 1 Korrik 1948 | Çmimi 2 dinarë

Sot fillon regjistrimi i Huas popullore

## Tue regjistrue Huan popullore te tregojme edhe nji here dashunin e zjarte ndaj atdheut t'onë

Sot, me 1 korrik, fillon kudo n'atdheun t'one te perbashket regjistrimi i Huas popullore.

Nepermjet te konferencave te shumta dhe solemne qe jane mbajte ne mbare Vendin t'one, njerzit punonjes e kane pershendete dhe me entuziazme kane marre persiper obligime te mdhaja per regjistrimin e Huas popullore. Shtresat e gjana te popullsis e kane kuptue drejte kete mase te Qeveris Qendrore dhe kane shprehe vendosmenin e vet me kontribue me te gjitha fuqit e veta per plotsimin e tejkalimin e kesaj detyre qe na parashtron atdheu. Prandaj shtresat t'ona punuese, perveç perpjekjeve per realizimin e Planit pesvjeçar, regjistrojne Huan popullore, per te krye vepren e madhe te ndertimit socijalist te Vendit t'one. Kjo asht plotsisht e kuptueshme, sepse kushtu e kerkon interesi i Planit pesvjeçar dhe i shtetit, e interesat e popullit perputhen ne tanesi me interesat e shtetit, e cila asht ne realitet, mjet per realizimin e deshires se shtresave te gjana popullore.

Koshjenca se Huaja qe e ka fillue Qeverija Qendrore, ka me e shpejtesue edhe ma teper rritmin e ndertimit te Vendit t'one dhe ka me ndikue ma teper ne ugritjen e gmatushime te mirqenjes se pergjithshme asht rrite edhe ma nga perpjekjet dhe sukseset e perditshme te te gjithe njerzve t'one punonjes. Per kete arsye popuj t'one jane te gatshem me vue ne dispozicjon te shtetit nji pjese te kursimeve te veta per ngjanimin dhe ma te madh te sukseseve te deritashme, sepse po e shofin perspektiven e zhvillimit dhe te perparimit te vazhdueshem te Vendit t'one, sepse jane te bindun se Huaja do te sherbeje per nji jete ma te pasun e ma te kulturueme per te gjithe njerzit punuesa te Vendit t'one. Nji vendim i ketille asht i natyrshem, sepse e merr populli, qe asht drejtues i fatit te vet, e per krijimin e jetes ma te mire e ma te lumtun asht i interesuem me e çfrytezue cdo mjet te vetin qe e ka ne dispozicjon.

Regjistrimi i Huas popullore po bahet ne vjetin vendimtar te Planit t'one pesvjeçar, kur do te kryhen pune kolosale investimi, qe do t'a shtojne edhe ma fuqin ekonomike te Vendit t'one.

Prandaj, asht detyre nderi e çdo nenshtetasi t'one me marre pjese aktive ne ket akcjon dhe tue regjistrue Huan popullore te tregojme edhe nji here dashunin e zjarrte ndaj atdheut t'one, ndergjegjen t'one te nalte patriotike, dashunin t'one te pakufishme ndaj Partis s'one te lavdieshme Komuniste te Jugosllavis.

## Deget sindikale te rrethit te Prishtines kanë premtue me regjistrue 4.347.500 dinare

Deget sindikale te qytetit dhe te rrethit te Prishtines, deri ne mesditen e dates 29 qershuer kane premtue se do te regjistrojne 4.347.500 dinare. 53 dege sindikale te ketij rrethi i kane perfshi, deri me daten 29 qershuer, afer 70 per qind t'antarve te vet me dhanjen e obligimeve per Huan popullore. Grupi i puntorve qe punon ne blokun e banimit nr. 3 ka premtue 114.500 dinare; dega sindikale e furres moderne per pjekjen e tullave 38.000 dinare; dega sindikale e komisjonit te planit 28.500 dinare; dega sindikale e Drejtorait te pergjithshem te Keshillit Popullor Krahinuer — 77.250 dinare; Drejtorati i tregtis — 103.750 dinare; Drejtorati i punes — 34.000 dinare; Drejtorati i punve te mbrendshme — 64.000 dinare; Keshilli Krahinuer i Sindikatave — 32.000 dinare; Antaret e deges sindikale te keshillit popullor te rrethit te Prishtines — 163.000 dinare; dega sindikale e gjyqit te qarkut dhe e Prokurorit Publike — 36.750 dinare; 30 nepunesa te bashkimit kooperativ te rrethit — 65.000 dinare; 47 nepunesa te sipermarrjes „Gmija" — 190.000 dinare; nji pjese e puntorve te fabrikes se tullave 107.000 dinare etj.

Ndihmesi i te besuemit te Drejtoratit socjal, Blagoje Miliqeviq ka dhane obligimin me regjistrue 152.000 dinare. 32 antar te deges sindikale te Drejtoratit Socjal kane marre persiper me regjistrue 200.000 dinare.

### Gara ne lidhje me Huan popullore ne keshillin e vendit Sedilar

Edhe ne keshillin e vendit Sedilar, Fronti popullor ka mbajte nji konferenc ne lidhje me Huan popullore. Keshilli i vendit te Frontit popullor vendosi me i shpalle gare ne lidhje me Huan keshillit te vendit te Frontit popullor ne Jashice, e katundi Sedilar — katundit fqij Krajmirovc. Aktivistat e Frontit i kane shpalle gare njeni tjetrit. Emin Halili, kryetari i keshillit te vendit i shpalli gare Vehbi Sejdis, kryetarit te kooperatives se vendit. Mislim Ajeti, ... i pyjeve i shpalli gare shokut te vet Hysen Bahtijarit; Shaip Arifi nxanes i klases se IV-te te shkolles fillore — Hamdi Kajtazit, gjithashtu nxanes i shkolles fillore, i riu Ahmet Islami i shpalli gare shokut te vet Reshep Kajtazit. Plaku 60 vjeçar Feriz Haja - Kolshi nga katundi Bnice u bap me Sejdi Bajramin dhe ne bisedim e siper i tha: «hoqe mor Sejdi e mendoju se me kend je kape. Do t'a shes kalin qe e kam ble per me udhtue me te, se jam plake e s'po muej me hece ne kambe, pa t'a kalue ne huan s'e lal".

### Kolektivi punues i Stari Trgut do te rregjistroje ma se 5 miljone dinare

Minatoret e minjeres „Trepça" ne Stari Trg kane dhane obligime kolektive per Huan popullore. Puntorija e e qerreve do te regjistroje 570.000 dinare e kolektivi punues i Stari Trgut do te regjistroje 5 miljona dinare. Antaret e Frontit te qytetit te Mitrovices, neper konferencat e deritashme te rejonive, kane premtue se do t'i regjistrojne 2 miljone e gjysem dinare per Huan popullore.

### Rrethi i Liplanit zhvillon gara me rrethin e Ferizajt

Ne Liplan asht mbajte plenumi i keshillit te rrethit popullor, ku asht bisedue mbi Huan popullore, mbi randesin e Huas popullore per realizimin ma te shpejte te Planit pesvjeçar, per shpejtesimin e procesit te ndertimit socialist te Vendit t'one.

Ne diskusjonin qe u-zhvillue muer pjese nji numer i madh antaresh te Frontit. Ne mbarim u-vendos qe rrethi i Liplanit t'i shpalle gare rrethit te Ferizajt se kush do te mberrije rezultate ma te mira ne lidhje me huan popullore.

Antaret e plenumit moren persiper me i perfshi ne Huan popullore te gjitha ekonomit shtepijake, me regjistrue maksimumin e Huas e keshtu me e prite Kongresin e Peste te Partis me rezultate te mdhaja edhe ne kete akcjon te randesishem.

*Ne nderë te Kongresit te Pestë te Partis Komuniste te Jugosllavis*

## Njizet brigada te kolektivit punues te sipermarrjes „Graçanica" e kane tejkalue planin mujuer me 23 qershuer

Ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, kolektivi punues i sipermarrjes „Graçanica" ne Prishtine ka marre persiper keto obligime:

1) Per çdo puntor me e tejkalue planin e prodhimit me 30 per qind,
2) Me çfrytezimin ma racjonal te materjalit me e mberrijte kursimin per shtate per qind,
3) Tue e nda mire fuqin puntore me e mberrijte perdorimin sa ma racjonal te saje,
4) Ne kuadrin e akcjonit katund-qytet me e ndihmue per çdo te djele ndertimin e shtepive kooperative,
5) Me e shtue orarin e punes prej 8 ne 10 ore me pagesen e zakonshme,
6) Deri ne diten e Kongresit me e krye ndertimin e ketyne objekteve:

10 shtepija ne blokun e banesave; poliklinikeн dhe dy shtepija banimi t'entit socjal te sigurimit, shkollen e mesme bujqesore; shtepin e kultures; nji shtalle te stacjonit bujqesuer model; puntorine dhe zyren e stacjonit bujqesuer te maqinave — te gjitha keto ne Prishtine — dhe 2 magazina drithi ne Podujeve. Puntorija e mbare kolektivit i asht perveshe punes me vetmohimin ma te madh per kryemjen e ketyne obligimeve. Puna zhvillohet me nji rrithem te shpejte. Brigadat zhvillojne gara vazhdimisht ndermjet vedi. Efekti dituer asht i madh dhe normat tejkalohen prej 10-200 per qind. Flamurin kalimtar e mbajne deri tash brigada e Mihailo Stefanoviqit, Janko Gjorgjeviqit dhe Ahmet Izetit. Ne dekaden e trete asht tue u-zhvillue nji lufte e rrebte per flamur. Simbas punes dhe evidences se deritashme parashihet qe t'a fitoje flamurin kalimtar brigada e Stojsllav Sllavkoviqit, e cila po e tejkalon normen per dite ma teper dhe brigada e Dushan Stojkoviqit.

## Punet per ndertimin e shtepis se kultures po zhvillohen me vrull te madh

Per perfundimin e ndertimit te shtepis se kultures ne Prishtine po punohet me nji rithem te shpejtesuem, e bile shpesh here edhe naten. Prej dates 24 deri me 27 qershuer asht punue ne tri ndrrime. Mbrenda kesaj kohe asht krye nji pllake betoni prej 700 metrash katrore. Ne perfundimin e kesaj pllake jane shque me punen e tyne te palodhshme pergjegjesi Millorad Petroviq si dhe puntoret Bajram Osmani, Maliq Tefiku, Veli Merxhani dhe Mehmet Shema, te cilet e kane tejkalue normen mesatarisht me 30 per qind. Gjithashtu, asht shque edhe rinija puntore e sipermarrjes „Graçanica", e cila ka dhane 105 ore pune vullnetare jasht orarit dhe ka mberrijte perfundime te mira. Ma se shumti asht shque e reja Perishiq Vukosave, mandej Spasa Iliq dhe te rijt Tomisllav Jankoviq e Gjoko Krstiq.

Tue fillue nga data 28 qershuer asht tue u-perdore metoda e re e murat imit. Qysh diten e pare jane korre perfundime te mira. Mbrenda dites, 9 mjeshtra me 5 ndihmsa kane ndertue 45,34 meter kub mur. Mirepo, ky rezultat ka mujte me qene edhe ma i madh sikurse puna t'ishte organizue ma mire. P. sh. nuk ka pase fuqi puntore te mjaftueshme per afrimin e dhanjen e tullave ne duer te mjeshtrave si dhe bajtjen e harasanit. Ne perdorimin e metodes se re te Turçiqit asht dallue mjeshtri Stevan Ajtiq. Ky bashke me nji mjeshter tjeter e 3 ndihmsa ka ndertue mbrenda nji dite 18,36 meter kub mur. Me rastin e marrjes s'obligimeve ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste mjeshtri Stevan iu ka shpalle gare te gjithe mjeshterve dhe puntorve te kolektivit. Mbas ketij dallohet ne pune edhe brigada e Et'hem Bajramit.

### Obligimet e antarve te Frontit ne rrethin e Prizrenit ne lidhje me garat para Kongresit

PRIZREN:

Hovi i garave ne ndere te Kongresit te Peste te Partis i ka perfshi te gjitha katundet e rrethit te Prizrenit. Ne konferencat e shumta te Frontit, qe po mbahen kudo, po merren persiper obligime te ndryshme.

Frontistat e katundit Dojnice, te keshillit popullor te vendit Lubizhde, kane marre persiper, deri ne diten e Kongresit, me dhane 650 ore pune vullnetare per ndreqjen e rrugeve; 600 ore pune vullnetare per ndertimin e shtepis kooperative si dhe me i prodhue 10.000 kg gelqere.

Frontistat e katundit Zym kane marre persiper qe ne vjetin e ardhshem shkollaret me i dergue ne shkolle te gjithe nxanesit pa perjashtim dhe per ket qellim e kane bo regjistrimin e te gjithe nxanesve t'afte per shkolle.

Frontistat e katundit Vrbičan kane marre persiper me dhane 500 ore pune vullnetare per ndreqjen e rrugeve dhe 600 ore pune vullnetare per ndertimin e shtepis kooperative. Antaret e Frontit te Karashingjergjit jane tue i transportue 350 m ter kub gure per ndertimin e shtepis kooperative.

## Kolektivi punues i minjeres Brezojce u shpallë gara minatorve te Rabroves dhe te Lojanit

Ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis i tane kolektivi punues i minjeres „Brezojce" ka marre persiper obligime te mdhaja. Nji nga obligimet e ketij kolektivi asht edhe perfundimi i rruges Brezovice — Badanac, me anen e se cilës do te transportohet minerali deri ke hekurudha industrijale. Kolektivi punues ka dhane per ndertimin e kesaj rruge per nji dite 1568 ore pune vullnetare. Mbas ketij akcjoni kolektivi punues ka mbajte nji konference, ku jane dhane obligime kolektive si dhe per çdo puntor veç e veç. Kolektivi punues i kesaj minjere i fton ne gara minatoret e minjerave te kromit ne Rabrovo dhe Llojan ne lidhje me plotesimin e tejkalimin e normes, pakesimin e mungesave te pajustifikueme, kursimin e landve djegese dhe materjalit tjeter, mbajtjen e maqinave sa ma ne rregull, ne lidhje me regjistrimin e Huas popullore dhe ne lidhje me ngritjen kulturalo-profesjonale te puntorve. Grupet e galeris kane premtue qe perveç punes se tyne te rregullt, deri ne diten e Kongresit te Peste te Partis te nxjerrin nga 100 tonelata minerale. Nepunesat dhe puntoret e kolonis kane marre persiper me ndertue me pune vullnetare nji kotec per derra t'ekonomatit te puntorve, si dhe me e ndertue nji krue ne koloni. Me rastin e marrjes se ketyne obligimeve te gjithe pjesemarresit e ketij kolektivi punues kane deklarue se Kongresin e Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis do t'a presin me rezultate te mdhaja pune, me anen e te cilave „do t'ia mbyllim gojen nxitesave te luftes dhe do t'i tregojme rrugen e drejte puntoris se mbare botes".

### Gara ne mes te keshillave popullore te vendeve

Ne mbledhjen e plenumit te keshillit te rrethit te Frontit popullor ne rrethin e Istokut, disa keshilla te Frontit popullor te vendeve i kane shpalle gare njeni tjetrit ne ndere te Kongresit te Peste te Partis. Frontistat e Dobrushes i kane shpalle gare atyne te Vrelles dhe t'Osojanit ne lidhje me ndertimin e shtepive kooperative; frontistat e Istokut u kane shpalle gare atyne te Vrelles, Dubraves dhe Jabllanices ne lidhje me transportimin e landes per centralin elektrik; frontistat e Zllakuçanit jane kape me ata te Klines, Jashanices, Shtupelit dhe te Zallçit ne lidhje me kontraktimin e drithnave dhe regjistrimin e Huas popullore. Keshilli i Frontit n'Osojan asht tue zhvillue gare me keshillat e Zllakuçanit, Zallçit, Klines dhe Jashanices ne lidhje me hapjen e sallave te leximit dhe te bibliotekave ne katunde.

### Sipermarrja „Ramiz Sadiku" i shpallë garë sipermarrjes „Graçanica"

Sipermarrja e ndertimeve „Ramiz Sadiku" ne Ferizaj i ka ftue ne gare te gjithe puntoret e sipermarrjes se ndertimeve „Graçanica" te Prishtines ne lidhje me garat e pergjithshme qe po zhvillohen ne mbare Krahinen t'one ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Puntoret e sipermarrjes „Ramiz Sadiku" kane marre persiper me e tejkalue normen mesatare me 20 per qind, me e kursye materjalin e ndertimit per 10 per qind dhe me e zhduke fare vonesen dhe mungesen e paarsyeshme nga puna.

### Obligimet e keshillit te Frontit popullor te rrethit t'Istokut ne lidhje me gara para Kongresit

Ne lidhje me garat qe po zhvillohen ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, keshilli i rrethit te Frontit popullor n'Istok ka marre persiper me e plotesue planin e kontraktimit te drithnave te bardhe para afatit te caktuem, me e plotesue planin e mbjelljes se leshit dhe deri ne diten e Kongresit me e perfundue ndertimin e shtepive kooperative ne katundet Dobrushe, Vrelle dhe Osojan.

### Korrja e drithnave te bardhe po zhvillohet me rithem te plote

Ne shumicen e rretheve te Krahines t'one korrja e drithnave te bardhe asht tue u-zhvillue me rrithem te plote e sidomos ne rrethet e Podrimes, Prizrenit, Suharekes, Istokut dhe Gilanit.

Qysh ne fillim te ketij akcjoni jane konstatue disa te meta e sidomos ke komisjonet e korrjeve prane keshillave te vendeve. P. sh. komisjonet nuk i kane perpunue si duhet planet e veta. Ne disa keshilla vendesh nuk jane njoftue prodhuesit mbi afatet e fundit te korrjeve per çdo kulture. Kjo i ka penguе pregatitjet e nevojshme per fillimin e korrjeve. Mirepo, keto te meta jane zhdukë ma vone. N'anen tjeter, asht vonue mjaft ndreqja e maqinave e sidomos t'atyne private, te cilat deri tash jane ndreqe me 60,30 per qind. Kesaj çashtje nuk i asht kushtue kujdes i duhun nga ana e keshillave te rretheve, te cilat kane pritë qe maqinat te ndreqen nga vet pronaret. Ne rrethin e Liplanit prej 55 maqinave jane meremetue vetem 28, me gjithse i kane kushtet e nevojshme per meremetim, kurse ne rrethin e Ferizajt dhe te Prizrenit jane ndreqe te gjitha maqinat.

Tue marre parasysh se afatet e korrjes se sivjesme jane te shkurta, duhet t'angazhohen edhe ma teper organet e pushtetit popullor, komisjonet e korrjeve dhe organizatat masovike, ne menyre qe te koordinohet puna sa ma mire si per korrje ashtu dhe per shirje e aty per aty te zhduken te gjitha te metat qe eventualisht mund te paraqiten.

### Mbledhja plenare e Keshillit Qendruer te Frontit popullor te Jugosllavis

# Ç'duhet ba per perforcimin dhe intensifikimin e matutjeshem te punes s'organizatave te Frontit?

Keshilli Qendruer i Frontit Popullor te Jugosllavis ne mbledhjen e tij plenare, mbassi ndigjoi referatin e Keshillit Ekzekutiv dhe diskutimin dha keto konkluzjone:

1. Te gjitha organizatat e Frontit Popullor duhet te perpiqen edhe ma teper per plotsimin e Planit pesvjeçar, per realizimin e te cilit luftojne turmat ma te gjana punuese te te gjithe popujve t'one, te vetedijshme se keshtu krijojne ardhmenin e vet ma te mire, se ndertojne socjalizmin, se sigurojne pamvarsin e Vendit te vet dhe shtojne fuqin e tij mprojtese. Asht veçanrisht e nevojshme qe te gjitha organizatat e Frontit Popullor t'i drejtojne perpjekjet e tyne qe permbushjen e suksesshme te detyrvet shum te randesishme qe shtrohen ne çastin e tashem para Frontit Popullor, siç asht: regjistrimi i huas Popullore, ndihmu e gjithanshme organeve te pushtetit popullor dhe sipermarrjeve ne furnizime drejte dhe me kohe te popullsis, per kryemjen e planit te grumbullimit, nepermjet te luftes per konstatimin e perpiket te tryteve dhe teprice reale te prodhimeve per treg, luftes per t'u ba te pamundeshem elementave spekulues shkeljen e Dekretit.

2. Ajo qe ka randesi te madhe per realizimin e suksesshem te detyrve te Planit pesvjeçar ne ket vjet asht lufta e Frontit popullor, e ne rradhe te pare sindikatave, per paksimin e shpenzimeve te prodhimit, per gjetjen e landeve te para rezerve, permirsimin e kualitetit te punes, shtimin e korsimit, sigurimin e fuqis puntore, zhvillimin e fuqive ekonomike lokale dhe çfrytzimin e mundesive lokale.

3. Detyre themelore e Frontit popullor ne katund asht zhvillimi i kooperativave bujqesore, nga format ma te nalta deri te ato ma t'ulta, nepermjet te te cilave do te kryhen plotesisht progresivizmi i bujqesis dhe rekonstruimi socjalist i katundit t'one.

Veçanrisht asht e nevojshme te shtohet veprimtarija e organizatave te Frontit ne ndertimin e shtepijave kooperative ne katund.

4. Fronti Popullor duhet t'i zhvilloje e t'i forcoje edhe ma teper te gjitha format e punes ne ngritjen e vetedijes politike te turmave te gjana. Fronti popullor duhet t'a organizoje gjanesisht punen politike-edukative t'antarve, tue shtrue ne plan te pare studimin e zhvillimit te Vendit t'one, revolucjonit t'one dhe rrugve te ndertimit te socjalizmit te na. Organizatat e Frontit popullor duhet t'a shtojne punen ne ngritjen ideologjike te turmes themelore t'antarve te vet ne frymen e socjalizmit, komunizmit, tue u-kujdesue ketu fort qe pjesmarrja n'ekete pune te bahet ne baze vullnetare.

5. Fronti popullor, si organizate politike e pergjithshme popullore, duhet t'a shtoje gjithnji punen e tij ne demaskimin e nxitsave te luftes dhe forcimin e fuqive te paqes dhe demokracis ne bote, fuqina ne krye te te cilave qendron Bashkimi Sovjetik. Ne lidhje me kete duhet te shtohet veçanrisht puna kundra reakcjonit te mbrendeshem, kundra mbeturinave te shpartallueme te reakcjonit borgjez, qe perhapin lloj lloj lajmesh te rrejshme, per t'a tubate bashkimin dhe diciplinen e turmave popullore dhe me mbjelle pakujdesin e mosbesim ndér to. Kta fare elementash dhe shoket e tyne perpiqen, ne mnyrna te ndryshime, me e ngadalsue rithmin e ndertimit t'one. Prandaj lufta politike kundra tyne asht kusht esencjal per mobilizimin e suksesshem te turmave dhe rithmin e matutjeshem te shpejte te ndertimit.

6. Per kryemjen e detyrve te sotshme shum te mdhaja ne Frontin Popullor, asht i domosdoshem shtimi i matutjeshem i punes s'agjitacjonit ne turmat dhe zhvillimi i shtypit te fuqishem politik dhe organizativ. Mbare agjitacjoni duhet me e konkretizue edhe ma teper, si e si masat te mobilizohen ne luften kundra te metave dhe gabimeve te ndryshme, si e si akcjonet konkrete te spjegohen gjanesisht dhe te lidhen me detyret e pergjithshme te Frontit si e si te zhvillohet hovi i punes dhe te kaperceben veshtirsinat.

7. Te gjitha organizatat e Frontit popullor duhet t'i kushtojne nji vemendje te posaçme organizimit t'akcjoneve vullnetare te punes, hartimit te planeve te punes t'organizatave te Frontit Popullor, sidomos perdorimit te drejte dhe racjonal te fuqis puntore vullnetare, perosjes s'evidences dhe statistikes.

8. Qe te mundet ma ndhelege me suksess punen e organizatave te Frontit Popullor, me zhvillue veprimtarin e tyne te gjithanshme, me punue ne forcimin e matutjeshem politik, ideologjik e organizativ te Frontit, asht nevoja qe keshilli ekzekutiv i keshillit qendruer t'organizoje organe ndihmese per deget e ndryshme te veprimtaris.

9. Per kryemjen e ketyne detyrve te Frontit asht nevoja qe t'organizohet si duhet puna e organizatave themelore te Frontit dhe t'u ndihmohet atyne ne gjetjen e formave organizative ma te pershtatshme te punes, n'organizimin ma te mire te punes arsimore, akcjoneve te punes etj., si e si çdo njeri te mundet me u ngrijte ma se shpejti politikisht dhe me kontribue ma teper.

*Per uljen e çmimit te plote te kushtimit*

## Kolektivi punonjes i fabrikes se tullave ne Prishtine ka mbrrijte me e ule çmimin e plote te kushtimit per 10 per qind

### Me perdorimin e hinit qe mbetet mbas pjekjes se tullave sipermarrjes i kursehen nga 4900 dinare ne dite

Kolektivi punonjes i fabrikes se tullave ne Prishtine, tue e zbatue urdhnesen e Qeveris Qendrore mbi uljen e çmimit te plote te kushtimit, ka hartue nji plan, simbas te cilit parashifet ulja e shpenzimeve te prodhimit per 5 per qind. Mirepo, me perpjekjet e vazhdueshme te mbare kolektivit punonjes asht mbrrijte qe, mbrenda nji kohe te shkurte, jo vetem te realizohet plani, por edhe te tejkalohet 100 per qind.

Ne rend te pare jane marre masa per kursimin e landve djegese. Ndertimi i furres moderne i ka dhane mundesi sipermarrjes me kursye 195 m. kub dru dhe 10 per qind te qymyrit e, çka asht ma me randesi, tash nuk perdoret ma qymyri i gurit, qe kushton ma shtrejte dhe ndikonte ne ngritjen e çmimit, por vetem lignit (qymyri i drunit) qe kushton ma lire.

N' anen tjeter, me inisjativen e drejtorit te sipermarrjes, ne vend te ranes qe kushtonte 350 dinare per meter 1 kub, asht tue u-perdore hini qe mbetet mbas pjekjes se tullave si nga furrat primitive ashtu edhe nga furra moderne. Perdorimi i ketij hini ka dhane perfundime edhe ma te mira se rana per kah kualiteti i tullave, e n'anen tjeter i kursehen sipermarrjes nga 4900 dinare ne dite. Kete gja asht mire qe t'a praktikojne edhe sipermarrjet tjera te ketij lloji te Krahines s'one. Tulla e freskei e pluhnueme me kete hi nuk ngjitet, as per tullat tjera, as per mjetet e transportit e ruen ma mire formen dhe forcohet ma teper.

Per uljen e çmimit te plote te kushtimit ka ndikue shum edhe mbledhja e pluhnit te qymyrit te gurit ase te lignitit qe mbetet me rastin e ngarkimit e te shkarkimit te vagonave ne stacjonin hekurudhuer, e per llogari te sipermarrjeve „Granap", „Granprek" etj. Ky pluhun nuk perdoret ma pare. Perdorimi i ketij si ne furren moderne ashtu dhe n'ato primitive ka dhane keto perfundime:

1) Pjeke dhe jep kalori ma te mire se sa copat e qymyrit, qe duhet te thehen ne proporcionet e duhuna;

2) Ka ndikue ne pakaimin e fuqis puntore dhe

3) Çka asht ma me randesi, me rret pa te holla. Deri tash kolektivi i sipermarrjes i ka mbledhe 7 vagona kesi pluhunime çka i ka kursye sipermarrjes ma se 30.000 dinare. Per pjekjen e tullave ne furrat primitive asht mbrrijte kursimi i qymyrit per 10 per qind.

Dheu qe po nxiret nga vendi ku do te ndertohet furra tjeter moderne, nuk po hidhet poshte si ne vjetin e kaluem, por po perdoret per premjen e tullave dhe ky po ndikon shum n' uljen e shpenzimeve te prodhimit.

Me inisjativen e puntorve jane ndreqe 7 vagoneta qe kane qene jashte perdorimit. Kualiteti i tullave asht permiresue per 50 per qind ne krahasim me vjetin e kaluem.

Ne ket menyre kolektivi punonjes i fabrikes se tullave ne Prishtine ka mbrrijte qysh tash me e ule çmimin e plote te kushtimit per 10 per qind.

## Lajmrim

Ne numrin e ardheshem te fletores s'one do te botojme Deklaraten e Komitetit Qendruer te partis Komuniste te Jugosllavis ne lidhje me Rezolucjonin e byros Informative te partive Komuniste mbi gjendjen ne partin Komuniste te Jugosllavis; Dekleraten e KQ te PKJ, date 20 qershuer te drejtueme sesjonit te byros Informative si dhe Vendimin e Komitetit Qendrur te partis Komuniste te Jugosllavis mbi perjashtimin nga partija t'Andrija Hebrangut dhe Sreten Zhujeviq.

## Abuzim detyre

Pariç Llazar, ndihmes arbetar i mensës se minieres „Golesh", tue perfitue nga besimi qe i ka dhane populli, ka vjedhe nga arka e minieres ne fjale shumen prej 16.000 dinaresh dhe nji harmonike te minieres.

Pariçi, me 19 maj ka qene largue nga miniera me drejtim te paditun. Me qe s'ka pase dokumenta qarkullimi, gjate udhtimit te tij ne hekurudhe ne pyetjet qe i ka ba sigurimi publik, ka deklarue se gjoja shkonte me ndreqe harmoniken per kolektivin e minieres. Ma vone ne Nish ka deklarue para organeve te se gurimit publik se gjoja ne hekurudhe i kishin vjedhe 16.000 dinaret, me te cilat shume do t'a ndreqte harmoniken dhe te plotesonte disa nevoja tjera per minieren.

Organet e sigurimit publik, tue ba betimet e duhuna kane mbrrijte me konstatue se i permenduni paret se bashku me harmoniken i kishte vjedhe, me qe edhe ate e kishte shite per 7.000 dinare ne ditet e fundit.

Pariç Llazari asht kape prej organeve te sigurimit publik dhe i asht dorzue gjyqit te popullit te rrethit te Prishtines per te marre denimin e meritueshem.

## Antaret e kooperatives bujqesore te punes „Stanko Buriq" bajne gare ndermjet vedi per regjistrimin e Huas popullore

Antaret e kooperatives bujqesore te punes «Stanko Buriq» — Vrella (Lipljan) e kane pershendete me entuziazem dekretin mbi huan popullore. Mbas konferences se mbajtun ne lidhje me huan, antaret e kooperatives ne fjale-malazeze, serbe, shqiptare e cigane, filluen me njihere garat shoq me shoq.

I pari filloi kryetari i kooperatives, Millan Zoraja, i cili n'emen te bretit shoi se vet, i shpalli gare asaj te Miço Radeniqit. Ky e thoi ne gare Bajram Ramadanin. Brigadiri Gjoko Shabanoviq i thoi ne gare kater brigadier: Riza Osmanin, Liuba Novakoviqin, Millan Bodirinin dhe Milivoje Vujaçiqin. Millan Mihoviqi, llogaritar i kooperatives thoi ne gare brigadirin, Gjoka Shabanoviq.

Shefi i Drejtoris se rrethit per ndertimin e shtepijavet kooperative, Vojin Bulaiqi, thoi ne gara shtepijat e Miço Radoniqit, Millan Zarajas dhe Isaf Ramadanit. Ljuba Novakoviqi, brigadir, thoi ne gare Toma Knjezheviqin antar i Drejtoris se kooperatives. Ilija Nikiq, antar i kooperatives asht kape me Bozho Vujaçiqin.

Edhe grate kaisat dhe rinija nisen garat ndervedi. Ljubica Aleksiq i shpalli gare Puzha Vujaçiq, Gospava Knjezheviqi — Anka Pobusheskaa; Anka Pobushevska — Petrusha Bulajiqit; Gospava Damjanoviq i ka shpalle gare Gospava Knjezheviqit, Katica Pobushevska — Katica Vujaçiqit.

Nxanesi i klases se pare te progjimnazit Dando Bulajiqi, i ka shpalle gare shokut te vet Miladin Knjezheviqit. Nxanesi i klases se IV-te te shkolles fillore Dragutin Shaqari i ka shpalle gare nxanesit te klases se III-te te gimnazit, Nikolla Shabanoviqit.

Nxanesi i klases se II-te te gimnazit, Milutin Amanoviq i ka shpalle gare shoqes Milena Vraçar.

Me gjithe se ishin te lodhun shum nga puna e dites dhe ishte bo mjaft vone, kolektivi i kooperatives „Stanko Buriq" ndejti deri ne mesnate tue kendue kange e tue luejte valle.

## Premtimet e frontistave te qytetit dhe te rrethit te Prishtines

Ne konferencat qe jane mbajte ne blloqet e ndryshme te qytetit te Prishtines, mbrenda nji dite 564 antar te Frontit kane premtue se do te regjistrojne 596.650 dinare. 81 antar Fronti te keshillit te vendit Milloshevo kane marre persiper me regjistrue 150.000 dinare. Frontjeti Rasha Bulfatoviq nga keshilli i vendit Obiliq asht obligue me regjistrue 25.000 dinare. Frontisti Vllada Samarxhiq nga katundi Dobreve e Poshtme ka premtue 10.000 dinare.

## Spastrim' i sektorit shtetnuer e kooperativ nga elementat abuzues

Sektori i jone shtetnor kooperativ, dita dites po spastrohet nga elementat abuzues, vete populli po i zen dhe po u ep denimin e merituem.

Radoniq Mileta, udheheqes i magazines nr. 4 ne Sllatino te Madhe, tue keqperdore pozitën e tij te besueme prej popullit, mbrrine me pervehtsue nga arka e shtetit shumen prej 32,290 dinaresh. I permenduni ka pas paftyresin me ba tregti me qellim profiti me rrobet qe kane qene caktue me u shite me çmime t'ulta puntorve. Keshtu, topin e pambukut qe kushtonte 300 dinare ma çmim t'ulte e ka shit ne shitje te lire per 2500 dinare, nji pale rrobe pune qe kushtonin 350 dinare i ka shite per 1365 dinare, metrin e bezit qe kushtonte 28 dinare e ka shit per 125 dinare e 50 sapojt «Merima» qe kushtonin 375 dinare i ka shite per 600 dinare. Keshtu qe diferencen ne mes te çmimeve t'ulta dhe t'atyne te nalta e ka pervehtesue ai per vehte.

Ky spekullant ka harrue se pushteti i sotshem asht popullor dhe si i tille i ndjek kamba kambes vjedhsat, dhe nuk i lejon te pasunohen ne kurriz te popullit.

Procedimet mbi vjedhesin Radoniq Mileta kane marre fund e i permenduni i asht dorzue gjyqit popullor per te marre denimin qe meriton.

## Ne Prishtine zbulohet nji grup ne lojen e bixhozit

Organet e sigurimit publik te qytetit te Prishtines, ne keto dite, ka zbulue lojtaret e bixhozit: Mustafa Ibrahimin, me profesjon rrobaqepes, Jusuf Zejnullahun, shites i rrobeve te vjetra, Qazim Ibrahimin i pa-profesjon dhe Sali Rexhepin puntor, qe te gjithe nga qyteti i Prishtines.

Me rastin e kapjes se tyne, ne tavalinen e lojes pervec 5786 dinare jane gjete te qituna ne loje edhe nji pallto, nji mantill, nji pale pantallona, 3 metra shtof dhe disa sahata xhepi e dore.

Ja pra, ne kohen kur te gjitha masat e gjana popullore i jane pervehe punes me vullnet e bindjen ma te madhe per ndertimin e shoqnis se re, per realizimin e Planit pesvjeçar qe te permirsojne jeten e masave te gjana punuese, ka ende njerez qe mundohen me anen e ketij vesit te mbrapsht parazit, grabites e dredharak, tue mashtrue vehten dhe tue dyeshe familjen e me duer kryq te rrnojne ne kurrizin e te tjerve.

Njerzit si keta nuk kane vend ne gjirin e shoqnis s'one. Gjyqi popullor ka me u dhane denimin e meritueshem.

## Puna vullnetare e sipermarjes se ndertimeve „Ramiz Sadiku" ne Ferizaj

Aleanca ne mes te puntoreve dita e dites po forcohet ne procesin e realizimit te Planit pesvjeçar.

Puntoret e sipermarrjes se ndertimeve "Ramiz Sadiku" ne Ferizaj, ne keto dite kane dhane pune vullnetare ne ndertimin e shtepijave kooperative ne keshillat e vendit Tankosiq e Duganjeve. Ekipa qi ka punue ne keshillin e vendit Tankosiq ka qene e perbame per 40 vetve, kurse ajo e Duganjeves prej 80 vetesh. Pjesa ma e madhe ne te dy ekipat perbahet prej mjeshterve, mbasi ne katunde puntoret ishin te mjafte.

Qe te dy ekipat kane punue nji jave rresht tue dhane 8 ore pune ne dite. Planin e kane kalue me 68 per qind ne ngritjen e mureve me gure.

Puntoret, nder te dy keshillat e vendit jane prit shum mire nga shoket e tyne katundare, me muzike, kange e parolla te shkrueme per aleancen e puntoreve dhe te katundareve. Gjate kohes qe kane ndejte ekipat, jane ushqye shum mire nga katundaret.

## Hapja e kursit per murator te gjyse-kualifikuem ne Gilan

Me 23 te ketij muej, ne Gilan asht hape kursi per gjysem te kualifikuem muratoresh. Kursi vazhdon pese muej. Ne ket kurs vozhdojne 40 ndjekesa serbe, shqiptare e malazeze. Kursi punon mbas oratit te punes. Epen 12 ore mesim ne jave, 2-3 ore ne dite, keshtu qe puntoret nuk humbin pagesen, por marrin rrogen rregullisht si u takon.

Kursistat baine jete internati, fjetjen e kane gratis dhe te mire, kurse per ushqim paguajne vetem 10 dinare ne dite.

Ne kurs, si lande mesimi jane parapa gjuhma amtare, gjeografija, historija, matematika, materiali i punimeve per ndertime e planet elementare ne ndertimin e mureve. Mesimet e dhanuna ne theori me njihere vehen ne praktike, d.m.th. se jane parapa ore theorike dhe praktike.

Si mesimdhanes jane caktue profesoret, inginjeret, punudhanesit dhe kryemuratoret.

Kursi asht organizue me inisjativen e Spiro Miçanoviqit, i cili pergjiget ne degen sindikale per sektorin kulturo-arsimor te sipermarrjes se ndertimeve Ramiz Sadiku ne Ferizaj.

## Arsim e Kulture

# T'i formojme kudo dhe t'i aktivizojme Bashkimet e shoqnive kulturo-arsimore

Qellimi i krijimit te Bashkimit Krahinuer te shoqnive kulturo-arsimore, se pari, asht qe t'unjisoje punen kulturore dhe arsimore te te gjitha shoqninave kulturo-arsimore dhe t'esteve te ketij rangu ne Krahine.

Per te mujte qe Bashkimi Krahinuer t'u ape atyne ndihmen e volitshme, duhet te jete ne lidhje te vazhdueshme me te gjitha shoqnit kulturo-arsimore, me organet arsimore te pushtetit populluer e me seksjonet perkatese ne kuadrin e organizatave masovike.

Deri tash ne Krahine jane formue vetem ne dy qytete e tri rrethe Bashkimet e ketyne shoqnive, prandaj duhet qe sa ma shpejte te formohen edhe nder rrethet e qytetet tjera. Veç kesaj, Bashkimi Krahinuer u parashtroi atyne si detyre per te formue shoqnina kulturo-arsimore edhe nder rrethe e çdo katund. Katundi me populli shqiptare duhet t'a formoje shoqnin e vet kulturo-arsimore shqiptare, keshtu edhe ai me populli serbe e malazeze, te veten. Nder katunde, ku do te kete shoqni shqiptare e serbe duhet te formohet Bashkimi i te dyjave, ne menyre qe t'unjisoje, koordinoje dhe te drejtoe punen e tyne.

Tue i formue dhe organizue keshtu shoqnit kulturo-arsimore dhe Bashkimet e tyne, do t'a permirsojme punen e gjithanshme kulturo-arsimore nder katunde e qytete, populli do te mesoje e prandaj do te jetoje edhe ma mire. Populli ka nevoje te madhe per arsim e kulture. Njeriu i mesuem e i kulturuem e shijon ma mire jeten, asht ma i afte per pune, e kupton ma mire realizimin t'one dhe detyret kundrejt Vendit t'one. Katundari me kulture i zgjidhe ma mire problemet ekonomike, shoqnore e politike jo vetem ne familjen e vet, por edhe ne katund; keshtu edhe puntori i kulturuem i zhvillue e i kupton ato ma shpejte; e zotnon ma mire punen, veglat dhe zejen e tij. Me anen e kultures s'one te re edhe femnat t'ona bahen luftari te barabarta per ndertimin e socjalizmit.

Sot, arsimi e kultura asht prone e massave te gjana popullore dhe jo si ne regjimet antipopullore, — privilegje vetem e nji pakice. Ne Vendin t'one kultura zhvillohet mbi baza te shendosha shkencore, i çon masat e gjana ne nji nivel ma te nalte, i afteson per ndertimin e socjalizmit. Sa ma te kulturueme te jene masat popullore, aq ma mire zhvillohet industrija, ekonomija, bujqesija etj., aq ma shpejte do t'a plotsojm Planin pesvjeçar.

Si per keto arsye, pra, roli i shoqnive kulturo-arsimore dhe i Bashkimeve te tyne asht shum i randesishem, prandaj atyne u ngarkohen detyre te shumta qe duhet t'i kryejne si duhet.

Ato, duhet te ndihmojne akcjonin kundra analfabetizmit dhe n'arsimin e popullit, t'organizojne kurse te mesme e te nalta arsimore, tue i aftesue kuadrat e duhuna, udheheqese. Po keshtu, ato duhet t'interesohen me hape biblioteka e librarina te reja nder ato vende ku nuk ka dhe, ato qe jane me i permirsue dhe pasunue me libra te reja. Seicili katund duhet te kete librarin dhe biblioteken e vet. Çdo rreth duhet te kete biblioteke te madhe e te pasun me libra, ne menyre qe t'u ndihmoje atyne te katundeve. Bashkimet e ketyne shoqnive duhet t'ia kushtojne kujdesin e veçante kualitetit te pjeseve theatrale, tue pase kujdes te veçante mbi permbajtjen, frymen edukative e ideologjike te tyne.

Massat e gjana popullore percdohen per shkencen e vertete, per dijen e re. Puna e riedukimit te mbare nji populli nuk asht aspak e thjeshte dhe e lehte, por kerkon pune te kujdesshme e te durueshme, te gjate dhe pregatitje te shendoshe. Bashkimet e shoqnive duhet te bajne çmos per permbushjen e kesaj detyre, per spastrimin e shkences nga metafizika dhe idealizmi, per t'ia dhane massavet kulture dhe shkencen e vertete ne frymen e socjalizmit.

Po keshtu, ato duhet t'i kushtojne randesi dhe kujdes te veçante edhe popullarizimit te kangve popullore, luftarake e te ndertimit nder katunde dhe qytete. Per kete duhet te pregatisin kuadra kompozitoresh, muzikantesh dhe koresh.

Bashkimet e shoqnive kulturo-arsimore do t'i zgjidhin me sukses te gjitha keto detyre, po qe se ne mes te tyne dhe t'organeve arsimore te pushtetit e te seksjoneve kulturo-arsimor t'organizatave masovike do te kete vazhdimisht koordinim pune. Keshtu, ato do te luejne rolin e randesishem ne zhvillimin e shpejte dhe ne ngritjen kulturo-arsimore te popujve te Krahines s'one.

# Regjistrimi real i analfabetve, statistika dhe evidenca ndihmojne shum per punen sistematike

Kushti kryesor qe masat t'ona popullore te ngrihen ne nji nivel ma te nalte kultural, asht qe luftimi i analfabetizmit te kryhet me plan.

Si detyre konkrete per permirsimin e gabimeve dhe te metave qe jane çfaqe aty ketu gjate punes ne ket drejtim, paraqitet regjistrimi real dhe ma i perpiket i analfabetve mashkuj e femna prej 14—45 vjeçe ne çdo qytet, katund, lagje e shtepi te Krahines s'one. Vete puna e deritashme na ka tregue se asnji qytet ase katund nuk e ka statistiken e sakte dhe evidencen e plote t'analfabetve te vete. Me gjithe qe, aty ketu, asht ba regjistrimi i atyne ne vitin e kaluem, prap se prap, dihet me siguri se kudo ka qinda e qinda analfabete — e sidomos femna — qe nuk jane regjistrue per nji arsye a nji tjeter.

Tue pase eksperience nga e kaluemja e afert, duhet qe çdo seksjon i arsimit te rrethit a qytetit tue e pase ndihmen edhe prej bashkimit te Shoqnis kulturo-arsimore, te formoje komisjone dhe ekipa me kuadra t'afta per t'ia fillue regjistrimit sa ma pare, keshtu qe te krynet deri me 21 korrik — diten e Kongresit te Peste te PKJ. Ket nevoje kaq te madhe si dhe regjistrimin e femijve per shkolle fillore e ka parapa edhe Bashkimi Kulturo-arsimuer i Krahines, tue ia paraqite Bashkimit te çdo rrethi e qyteti, ne menyre qe deri atehere ai te kryhet kudo dhe ne perpikni.

Vetem keshtu mund te mbahet evidenca e rregullt dhe t'organizohen kurset analfabetike me plan. Tue e pase statistiken e sigurt, nuk ka me ngja qe ne fund — kah faza e fundit te likuidimit t'analfabetizmit — te mbeten ende analfabete.

Qe kurset analfabetike t'udhehiqen prej kuadrave t'afte, asht parapa qe te hapen dy kurse njimujorshe per udheheqesa nder rrethe e qytete, njeni ne shtatuer dhe tjetri ne tetuer. Aty do te mesohen dhe te pregatiten kuadrat, te cilet kane me qene ne gjendje me i udheheqe ma mire kurset, te permirsojne kualitetin e dhanjes se mesimit etj.

## Fiskultura dhe Sporti

# Ndeshjet e kampjonatit te fodballit ne Krahinë per „kupen e Jugosllavis"

Ne vazhdim te kampionatit te footballit per kupen e Jugosllavis, diten e diele me 27 qershuer u ndeshen keto skuadra te zones se peste Kosmet — Sanxhak:

Ne Prishtine — „Proleter" — „Borac" nga Ferizaj. Loja perfundoi 4:0 ne favor te shoqnis sportive „Proleter". Ne Vuçiterne — „Trepça" e Mitrovices dhe „Radniçki" i vendit. Loja perfundoi 7:0 ne favor te „Trepçes". Ne Peje — „Buduçnost" — „Bratstvo" nga Prishtina. Loja perfundoi 3:1 ne favor te shoqnis sportive „Buduçnost".

„Metohija" e Prizrenit ka qene ne pushim.

Prandaj ne baze te rezultateve te javes se kalueme per semifinale te kesaj zone u kualifikuen SH. F. „Proleter" nga Prishtina, SH. F. „Trepça" nga Mitrovica, SH. F. „Buduçnost" nga Peja dhe SH. F. „Metohija" nga Prizreni.

### Ndeshjet finale te fotballit ne Prishtine

Te dielen me 4 korrik ndeshen kater skuadrat fituese per finale. Ne Mitrovice luejne „Buduçnost" nga Peja dhe «Trepça» e vendit. Ne Prizren „Proleteri" i Prishtines kundra „Metohis" se vendit. Dy skuadrat fituese kualifikohen si te parat ne zonen Kosmet — Sanxhak dhe do te ndeshen me skuadrat e ndryshme te Serbis, fituese te zonave.

### Fiskultura dhe sporti ne degat sindikale duhet t'aktivizohet sa ma pare

Shumgarshi populluer ne Krahinen t'one fillon me 1 korrik dhe vashdon deri me 15 korrik. Do te ndeshen ekipat e aktivave fiskulturore te rinis katundare, junioret e ketyne ekipave, ekipat e shoqnive te ndryshme sportive dhe a te degve sindikale. Ekipet ma te mira qe do te dalin neper rrethe do te mblidhen ne Prishtine, ku mbas ndeshjeve do te zgjidhen kater ekipat ma te mira: ekipa e mashkujve me juniore dhe ekipa e femnave me juniore, te cilat do to marrin pjese ne ndeshjet e shumgarshit ne Republiken Popullore te Serbis.

### Shumgarshi populluer ne Kosmet fillon me 1 korrik

Fiskultura dhe sporti ne shum dega sindikale te Prishtines ne kohen e fundit asht lane mbas dore. Kjo ka rrjedhe nga se udheheqesinat sindikale, sidomos pergjegjesat per fiskulture nuk jane interesue sa duhet per ket dege te punes sindikale dhe nga se as bashkimi fiskultural i qytetit nuk ka dhane kurrfare iniciative ne lidhje me kete. Derisa djemt e ri te shumten e kohes jashta orarit zyrtar e çlirtesoine, te thashe, ne kotesina, atehere pse te mos organizohet ndonji gare ne dege te ndryshme sportive? Bj. fj. do te mund t'organizohej nji kampionat ndermjet degave sindikale te Prishtines ne foot — ball, basket—booll dhe volibol. Gadi nder te gjithe antaret sindikalista egziston nji deshire e tille, e as rekvizitat as fusha nuk mungojne.

### Lajmerim per lexuesat dhe ndreqje gabimesh

Lajmerohen lexuesit e fletores s'one „Rilindja" se tue fillue prej dates 1 korrik 1948 fletorja do te botohet nga dy here ne jave like del rregullisht çdo t'Ejte dhe te te Djele.

Ne numrin e kaluem te fletores t'one „Rilindja" kane kalue keto dy gabime shtypi:

1) Ne faqen e pare, shtylla e dyte, rreshti 19 nga fillimi i shtylles asht shlyemja e kuanave kurse duhet te jete **shlyemja e borxheve.**

2) Ne faqen e trete shtylla e pare n'artikullin „manifestimi fiskultural" ne rreshtin e 34 nga fundi duhet te jete: **shoqnis se re „Polet"** ne formacjonin „Tito".

**Redakcija**

### Ndeshja e skuadrave perfaqesuese te Jugosllavis dhe te Shqipnis perfundi 0:0

Te djelen me date 27 qershuer u ndeshen ne Beograd skuadrat perfaqsuese te Jugosllavis dhe te Shqipnis per kampjonatin e footballit n'Europen Qendrore. Loja qe shum e gjalle nga te dy anet. U dalluen nga ana e Jugosllavis vija e pare dhe nga ana e Shqipnis mbroja dhe veçanerisht centarhalfi dhe portjeri.

Loja perfundoi 0:0.

### Katundaret e Qirezit ndertojnë shkollën e katundit

Populli i Qirezit, tue e ndie nevojen e arsimit, ka fillue me ndertue lokalin e shkolles fillore tue pase ne ndihme edhe pushtetin populluer te vendit. Tash asht ba i gatshem materjali qe gjindet ne vend: guret, rana, e gelqerja. Perveç kesaj, jane hape edhe themelet. Para sa ditesh u-mbajt nji miting ne vendin ku po ndertohet shkolla dhe populli premtoi se deri me 21 korrik — diten e mbajtjes se Kongresit te Partis Komuniste te Jugosllavis — do t'a mbaroje muratimin e lokalit te shkolles fillore.

Ne mbarim te mitingut populli i dergoi Mareshallit Tito nji telegram.

M. Raça

*M. I. KALINJIN*

# Me ndihmue ngritjen kulturale në massat popullore, me marrë pjese çdo dite ne jeten shoqnore-e ka per detyre çdo mesues

"....Tash do te flase mbi çashtjet e jetes shoqnore. Ketu ka randesi qe mesuesi t'u afrohet njerzve, realitetit, te mesoje me u-orjentue ne situaten e vendit. Kuptohet se do t'ishte nji gja ideale sikur te gjithe mesuesat t'one dhe kuadrat tjera t'intelektualeve t'one t'a pervehtesojshin ne tanesi marksizem-leninizmin. Por, nuk do te jete e keqe sikur t'i dijne se paku edhe themelet e pergjithesme te kesaj theorije. Kjo nuk asht e keqe-as per komunista as per njerzit jashta Partije. Une jam i bindun se disa jashta Partije e njofin ma mire marksizem-leninizmin se sa disa antare te Partis. Por, kesi njerezish ka shum pak. Ketu asht nevoja me mesue me u-marre ne menyre marksiste me çashtjet e jetes se vendit, me i analizue drejte. Mirepo ne referatet qe i mbani ju para popullsis dhe mbi te cilat keni fole ketu, mungon krejte jeta lokale. Qe, sa njerez folen ketu, e asnji nuk tha se ka pase rast me mbajte referat mbi ndonji ndodhi lokale. Pra, njerez lindin, vdesin, martohen, gezohen. Nji mori ndodhinash shoqnore... A nuk ka per t'u thane gja, ase a nuk mund te flitet mbi kete? A pak shkase paska?

Ndertimi kolhozjan, zhvillimi i ekonomis-te gjitha keto, e zgjojne mendjen e kolhozjanit, e lidhin kete me sferat e gjana shoqnore. Materjal per referate interesante ka edhe teper.

Kolhozet japin puntore te shkelqyeshem dhe referatet mbi njerezit e tille, tue dhane edhe konkluza, tue paraqite anet e tyne pozitive e negative, pa tjeter do te provokojne diskusjone te gjalla. Nga diskutimi i shendoshe mbi referate te tilla zhvillohet fizionomija e kolhozjanit, shtohet respekti ndaj punes kolhozjane.

Ne kolhozin fqinj nxjerren nga 10-12-15 metra centi prej nji hektarit, e ke ju ne kolhoz 5-6.-Pse ka qene ke ju prodhimi i dobet? Qe ku keni themen per referat.

Me nji fjale, kur hyni ne jeten e katundarit, kur diskutoni me punue me popullsin, atehere, prap, bani ashtu qe te kete lidhje direkte, te ngushta me jeten, te preke damaret, t'u interesoje njerezevet referati juej. Atehere populli do te vije pa tjeter me ndigjue referatet t'ueja. Kuptohet vetvetiu se ngjarjet shoqnore e politike ne jeten e vendit t'one dhe te mbare botes gjithmone japin edhe teper materjal.

Ma ne fund, nevojitet me diskutue lirisht mbi referatet dhe qe njerezit te kene qendrim ma taktik ndaj formes se paraqitjes se mendimeve. Kryesorja, asht te kuptohet ideja themelore e referatit dhe, pjesemarrsat ne diskutim te japin mendimin e tyne mbi te tue mos u-shtrengue nga forma e paraqitjes, tue pase ngulitaz ne mendje se çashtja e formes se paraqitjes asht gja qe fitohet. Randesi ka qe kejcili te tregoje mendimin e vet.

Mesuesi duhet ta jape fjalen e tij me ndere ne jeten shoqnore kudo qe mundet, kudo qe e pyesin per mendimin e tij. Ke katundari duhet t'egzistoje respekti ndaj mesuesit, jo vetem si mesues qe asht, por edhe si njeri. T'a kemi ndermend se kjo asht çashtje politike. Kjo asht çashtje e thelle politike. Po deshtet qe mesuesat t'a zane vendin qe u pergjigjet, atehere zbatoni nji linje t'atille qe mesuesi te jete i pa-anshem, te mos frigohet me e çfaqe mendimin e vet me rastin e kesaj ase asaje çashtjeje. Me rastin e zgjedhjes se çashtjeve katundare, mesuesi, natyrisht, mund te ndihmoje ne qofte se asht qytetar i atij vendi, ne qofte se merr pjese ne jeten e tane politike e ekonomike te tij.

Kryesisht mesuesi mund t'i ndihmoje katundaris ne fushen kulturore.

Ideja mbi kulturen asht shum e gjane-prej te lamunit te flyres deri ne majet ekstreme te mendjes se njeriut. Dhe, t'a kemi ne mend, kete asht ma lehte se kudo tjeter me rreshqite ne mikroborgjezi. Pastertija e durve, veshembathja e mire, mobiljet e duhuna ne banese etj.- te gjitha keto jane shenja te kultures shoqnore. Mbledhjet shoqnore, qerthujt dramatike, çfaqjet me ballo etj.- jane shenja te kultures shoqnore. Por, te gjitha keto mund te kthehen ne kalim te thjeshte te kohes. Dhe per t'a dallue kufinin ndermjet mikroborgjezis dhe zhvillimit verte kultural, nevojitet nji kulture dhe nji politike e mire. Marksistet i shiqojne sukseset si majet, si shkalle te re per perparimin e mamotjeshem. E per mikroborgjezin-kjo asht nji gja qe ka per qellim vetvehten, ai dishron me i stabilizue sukseset e tija, bahet rob i ketyne rasteve, tue e forcue edhe moralin perkates, tue e vue mendjen ne gjum. Kundra kesaj duhet me luftue.

Prandaj, asht e dishrueshme qe ju, me rastin e zbatimit te punes kulturore, te shtini ne te edhe elementet shoqnore-shtetnore, te shtini politiken, se per ndryshe kultura e juej do te humbe orjentimin dhe do te fitoje karakterin e t'ashtuquejtunes "kulture te rrethit", do t'a humbe lidhjen me kulturen e pergjithshme shtetnore, me interesat e pergjithshme kulturore.

Punen kulturore, te cilen e kryeni ju, duhet me e lidhe me ndertimin e pergjithshem socjalist e te mos mendoje njeriu ne menyre t'izolueme. Mikroborgjezi-asht njeri i cili mendon ndamas, ne menyre t'izolueme, i cili nuk e lidhe vehten me kurrgja dhe me kurrkend.

Kjo pune asht shum e veshtire. Asht shum e veshtire dhe shum delikate sepse duhet te jeni ju vete te kulturuem. Ketu, asht njisoj si ne muzike. Muzikanti do t'a kape noten e gabueme ne muzike, e une nuk do te hetoj as te te tane shkallen e gabimeve, sepse un nuk kam haber nga muzika. Kur e ndine noten e gabueshme duhet me e ndreqe.

Me rastin e vendimeve te Konferences se Londres mbi Gjermanin

# Deklarata e ministrave te punve te jashtme te Bashkimit Sovjetik, Shqipnis, Bullgaris, Çekosllovakis, Jugosllavis, Polonis, Rumanis e Hungaris

Varshave, 24 Qershuer.

Deklarata e ministrave te punve te jashtme te Bashkimit Sovjetik, Shqipnis, Bullgaris, Çekosllovakis, Jugosllavis, Polonis, Rumanis e Hungaris me rastin e vendimeve te Konferences se Londres mbi Gjermanin u-aprovue me 24 qershuer ne Konsultën e ministrave ne Varshave. Ne deklarate thuhet:

„Ne diten e 7 qershorit u shpall komunikata mbi mbarimin e Konferences se Londres te tri shteteve — Shteteve te bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe e Frances — mbi çashtjen e Gjermanis. Ne komunikate jane parasqite vendimet mbi Gjermanin, mbi çashtjet kryesore politike e ekonomike, qe u-aprovuen n'at Konferenc te mshefte, si dhe mbi çashtjen e ndryshimit te kufijve prendimore te Gjermanis, me gjithse nga referatet qe kane dale ne shtyp shihet se komunikata i kalon heshtazi disa vendime t'aprovueme ne Konference.

Konferenca e Londres asht thirre ne kundershtim me marreveshtjen e Potsdamit, simbas te cilës çashtjet qe kane te bajne me Gjermanin duhet t'i zgjidhin kater shtetet — Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkueme t'Amerikes, Britanija e Madhe dhe Franca. Shqyrtimi i ketyne çashtjeve i ka qene besue Keshillit te Ministrave te Punve te jashtme, te perbame prej perfaqesuesve te ketyne shteteve. Gjithashtu nuk mund te kalohet fakti se per te marre pjese ne kete konsulte separatiste te tri shteteve jane thirre edhe vendet e Beneluksit (Belgjika, Holanda e Luksemburgu), me gjith se nuk kane marre pjese ne te shtetet qe kufizohen me Gjermanin, siç jane Polonija e Çekosllovakija, dhe as vendet tjera t'interesueme drejt per se drejti.

Thirrja e Konferences separatiste te Londres mbi çashtjen e Gjermanis dishmon se qeverinat e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe e Frances, te cilat e kane organizue ket Konference, ia kane shtrue veltes per qellim likuidimin e Keshillit te ministrave te punve te jashtme, i cili asht formue ne Konferencen e Potsdamit, si dhe likuidimin e mekanizmit te kredive te kontrollimit te Gjermanis, te formuem sipas perparu simbas marreveshtjes se kater shteteve. Kjo shkelje e marreveshtjeve te perparshme ndermjet SH. B. A., BRSS, Britanis se Madhe e Frances mbi çashtjen e Gjermanis si dhe shkelja e detyrimeve ne pikepamje te konsultimit me shtetet e interesueme po zbatohen ne sy te te gjithve dhe çon kah germihja e marreveshtjes se Potsdamit mbi demilitarizimin dhe demokratizimin e Gjermanis, ka per qellim mos me lejue pertrimjen e agresjonit gjerman ne t'ardhme.

Keto shkelje te marreveshtjeve mbi Gjermanin prekin interesat jetesore jo vetem te kater shteteve qe okupojne Gjermanin dhe shteteve qe i kane qene ekspozue agresjonit gjerman, por edhe interesat e te gjitha shteteve europjane qe duan krijimin e paqes se shendoshe e te qendrueshme n'Europe.

Siç dihet, marreveshtjet ne Jalte e Potsdam shtrojne si qellim çarmatimin dhe likuidimin e industris luftarake te Gjermanis, asgjasimin e bazes se militarizmit gjerman dhe mbylimin e pertrimjes se Gjermanis si shtet agresiv e keshtu kthimin e Gjermanis ne shtet paqedashes e demokratik. Veç kesaj, marreveshtjet ne Jalte e Potsdam parashohin qe Gjermanija t'i paguej damshperblimet dhe me kete, bare pjeserisht, t'ua shperblejë demin vendeve qe jane damtue nga agresjoni gjerman.

Vendimet e Konferences se Londres te tri shteteve me pjesemarrjen e Beneluksit kane qellime tjera. Keto vendime i hjedhin poshte plotesisht detyrat e demilitarizimit dhe demokratizimit te Gjermanis, detyrat e transformimit te Gjermanis ne shtet paqedashes e demokratik dhe pergjithesisht i kane lane ne harrese çashtjet e detyrimeve te Gjermanis ne damshperblimet. Vendimet e Londres nuk kane per qellim me e pengue mundesin e agresjonit te ri gjerman por me e lidhe pjesen prendimore te Gjermanis, e para se gjithash industrin e rande te Rurit, ne vegel te rindertimjes se potencjalit luftarak te Gjermanis si e si t'a çfrytojne per qellimet ushtarake — strategjike te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes e Britanis se Madhe. Kuptohet se plani i ketille nuk ka se si te mos krijoje brenga te perdhuneshme per pertrimjen e agresjonit gjerman.

Krahas me ket, vendimet e Konferences se Londres tregojne se ka asht vuejtuni kryesuer i „aleances ushtarake prendimore" te cilen e kane formue ne kohen e fundit qeverinat e Britanis se Madhe, Frances, Belgjikes, Holandes e Luksemburgut mbi patronatin e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes. Konferenca e Londres, ne te cilen kane marre pjese edhe Shtetet e Bashkueme t'Amerikes, nuk ia ka caktue veltes per qellim ndalimin e agresjonit te ri gjerman, por qellime krejt te tjera, bile edhe ma te hapta se „aleanca ushtarake prendimore" e cila perfshine ne vehte pese shtetet e permendun. Mbasi ka pa se asht e pamundun me e fute tane Gjermanin ne planet ushtarake—strategjike t'Shteteve te Bashkueme t'Amerikes dhe Britanis se Madhe, Konferenca e Londres synon me i transformue zonat perendimore te Gjermanis ne baze te ketyne planeve, tue i shkeputë keto zona nga Gjermanija tjeter.

Vendimet e Konferences se Londres kane per qellim me e perçà dhe coptue definitivisht Gjermanin. Mbasi refuzoi njohjen verbale t'unitetit politik e ekonomik te Gjermanis, per te cilin perpara, qeverinat e Sh. B. A., Britanis se Madhe dhe Frances kane dhane deklarata, Konferenca e Londres ka pregatite krijimin e qeveris per pjesen prendimore te Gjermanis, pjese e cila, me akcjone separatiste te shteteve te permendura, do t'ishte e ndame nga pjesa tjeter e Gjermanis. Prandaj asht parapa thirrja e Asamblës kushtetuese te zgjedhun apostafat te perfaqesuesve te zonave t'okupimit britanik, amerikan e francez, çka duhet te sigurojne formimin e qeveris marionete per pjesen prendimore te Gjermanis e prej elementave t'atille, te cilet u jane te pershtatshem pushtetevet t'okupimit ne zonat prendimore te dhe jane te lidhun me lidhje te ngushta me monopolet kapitaliste amerikane e britanike, por nuk jane te lidhun me popullin gjerman dhe kane qendrim armiqsuer ndaj aspiratave te tija demokratike. Kjo don me thane se ndermjet Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe dhe Frances asht lidhe kontrata mbi zbatimin e perçamjes dhe coptimit te Gjermanis dhe me krijimin e nji qeverije t'atille separatiste ne zonat prendimore, e cila duhet t'i kundershtoje kerkesat e drejta te popullit gjerman per unjisimin dhe demokratizimin e Gjermanis. Veç masave te permendura per perçamjen politike dhe coptimin e Gjermanis, qeverinat e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe dhe Frances tashti po zbatojne masa se reja edhe per perçamjen dhe coptimin ekonomik te Gjermanis.

Me njiherë mbas mbarimit te Konferences se Londres, qeverinat e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe dhe Frances fillojen me zbatue reformen separatiste te valutes per zonat prendimore, e cila asht shpalle me 18 qershuer, me gjithse komunikata e permendun i ka kalue heshtazi vendimet e Konferences se Londres mbi ket çashtje. Reforma separatiste e valutes ne zonat prendimore te Gjermanis asht zbatue me gjithe nevojen e dukshme te kthimit te reformes unike te valutes per mbare Gjermanin, ne pajtim me marreveshtjen ndermjet BRSS, SHBA, Britanis se Madhe dhe Frances, siç e ka propozue qeverija sovjetike. Ne vend te sjelljes te deritashem unik te valutes, me marken unike per te tane Gjermanin, siç ka qene caktue dikur ne marreveshtjen e kater shteteve, qeverinat e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe dhe Frances e zbatuen, ne menyre separatiste, reformen valutare dhe per pjesen prendimore te Gjermanis caktuen marken e posaçme.

Ne pikpamje ekonomike, kjo ven pengesen ndermjet pjeses prendimore te Gjermanis dhe Gjermanis tjeter dhe qet veshtirsina tjera te shumta per likuidimin e krizit ekonomik dhe per rindertimin e ekonomis popullore te Gjermanis. E tane reforma e valutes ne zonat prendimore te Gjermanis zbatohet me llogari qe te sigurohen fitimet per kapitalistat, e, para se gjithash, per ato monopole gjermane, qe jane te lidhuna ngusht me monopolet kapitaliste amerikane dhe britanike, gja qe kercenon me sjelle shtimin e papunesis dhe keqesimin e gjendjes materiale te njerzve te punes ne Gjermanin prendimore dhe veshtiresina te reja ne marredhanjet ekonomike me vendet tjera. Keto jane pasoja te pashmangshme te Konferences se Londres, vendimet e se ciles çojne ne kryemjen definitive te perçamjes dhe coptimit politik dhe ekonomik te Gjermanis.

1) Zbatimi i politikes se perçamjes dhe coptimit te Gjermanis e bin te pamundun lidhjen e traktatit te paqes me Gjermanin, gja pa te cilen nuk mund te mbaroje gjendja e vazhdueme e luftes dhe regjimi i okupimit n'Europe. Nuk asht gja e rastit qe ne komunikaten mbi konferencen e Londres nuk flitet kurrgja mbi traktatin e paqes me Gjermanin dhe la nuk preket çashtja e pregatitjes se traktatit mbi paqen. Vendimet e Konferences se Londres, te mbajtun nga Shtetet e Bashkueme t'Amerikes, Britanija e Madhe dhe Franca me pjesemarrjen e Beneluksit, vertetojne se qeverinat e ketyne shteteve dhe qarqet gjermane t'afermë me to nuk jane t'interesueme per lidhjen sa ma te shpejte te traktatit te paqes me Gjermanin dhe per terhjekjen sa ma te shpejte te trupave t'okupimit nga Gjermanija.

Ne vend, qe ne menyre paqesore, t'a rregullojne problemin e te tane Gjermanis, qeverinat e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe dhe Frances kane pregatite aplikimin e t'ashtuquejtunit statut t'okupimit ne zonat prendimore te Gjermanis, gja e cila me shprehje posaçerisht te mjergullta, paralajmerohet ne komunikaten e Londres. Interesat e te gjithe popujve paqedashes kerkojne lidhjen sa ma te shpejte te traktatit te paqes me Gjermanin, i cili duhet t'a suprimoje regjimin e okupimit ne Gjermani dhe t'a kthejë popullin gjerman plotesisht ne kushtet e zhvillimit paqesuer e demokratik kurse qeverinat e SH. B. A., Britanis se Madhe dhe Frances nuk dishrojne me e lejue lidhjen e shpejte te traktatit te paqes me Gjermanin dhe synojne me u a impozue zonave prendimore te Gjermanis „statutin e tyne t'okupimit", si e si t'a vazhdojne arbitrarisht okupimin e Gjermanis, tue ia impozue popullsis gjermane barren e shpenzimeve t'okupimit per nji seri te gjate vjetesh.

Politika e ketille e pushtetit amerikan, britanik e francez, e cila çon kah robnimi i popullsis gjermane dhe kah çuemja zhag e rregullimit paqesuer te problemit n'Europe, nuk mund te harmonizohet me detyrat e transformimit te Gjermanis ne shtet paqedashes e demokratik dhe nuk asht ne pajtim me aspiratat e popullit per vendosjen sa ma te shpejte te paqes demokratike n'Europe.

2) Vendimet qe jane marre ne Konferencen e Londres mbi rendin shtetnuer te zonave prendimore te Gjermanis jane te pershkueme me frymen antidemokratike. Te gjitha pregatitjet per thirrjen e t'ashtuquejtunes Asamble kushtetuese dhe per hartimin e statutit gjerman u jane lane ne dore tre guvernatorve ushtarake dhe kryetarve te qeverinave te vendeve te zonave prendimore t'okupimit te Gjermanis. Ketu jane neglizhue fare partinat demokratike, sindikatat dhe organizatat tjera demokratike, qe perfaqsojne interesat e popullit gjerman. Interesat e paqes dhe sigurimit te popujve t'Europes kerkojne likuidimin e centralizimit hitlerian t'administrates shtetnore te Gjermanis, e cila i ka mgjasue Landtaget (asambleat e shteteve) dhe administrimin autonom te vendeve, — dhe rimekambjen e decentralizimit t'administrates, qe ka egzistue para regjimit hitlerian, me pertrimjen e Landtagut dhe dy Dhomave te pergjithshme gjermane. Kjo do t'a sigurojë unitetin e Gjermanis dhe reorganizimin e shtetit ne baze te parimeve paqedashse dhe demokratike, nen kushtin qe organizatave demokratike t'u jepet mundesija e veprimtaris se lire. Vendimet e Konferences se Londres synojne diçka krejt tjeter. Nen pretekstin qe te mos lejohet pertrimja e Rajhut te centralizuem, Konferenca e Londres perpiqet me e shty Gjermanin mbrapa dhe me ia impozue popullit gjerman nji rend federativ shteti, ku pushteti kryesuer do t'u dorezohej disa vendeve, e administrata e pergjithshme shtetnore do te kufizohej me funksjone te rendit te dyte, me gjithse kjo asht ne kundershtim me zhvillimin modern te shteteve demokratike.

Ky plan anglo-amerikan ka per qellim ndamjen e Gjermanis, gja qe çon n'asgjasimin e shtetit gjerman ne vehte. Realizimi i ketij plani te federalizmit (ndamjes) se Gjermanis e dorezon idën e unitetit te Gjermanis ne duert e shovenistave dhe revanshistave gjermane te cilet synojne me e rimkambe Gjermanin si vend militarist, si vend dominues mbi popujt e tjere. Per ket shkak do te vigjallet ideja e revanshit, do te forcohet shovenizmi per te cilin egziston ne Gjermani terren'i pershtatshem, dhe do te krijohen kushtet per çfaqjen e Bizmarkave te ri ase bile edhe Hitleravet te ri. Po qe se aspiratat e popullit gjerman per nji Gjermani unike bahen perseri vegel ne duer te shovenistave e militaristave gjermane, te cilve pushteti okupues ne zonat prendimore te Gjermanis u ka dhane naltje te madhe, atehere pa tjeter kjo do te sjelle perseritjen e agresjonit gjerman me pasoja shum te randa per popujt e Europes, tue perfshi edhe popullin Gjerman, çka i detyron popujt paqedashes me i forcue masat per luftë kundra nxitsave te luftes se re.

3) Politika qe zbatojne shtetet okupuese ne zonat prendimore te Gjermanis u jep ndalje elementave revizioniste gjermane. Ata zhvillojne fushaten kundra vendimeve te Konferences se Jaltes e Potsdamit mbi demokratizimin dhe demilitarizimin e Gjermanis, mbi detyrimet e saja ne pikpamje te shperblimit te damit te shkaktuem nga agresjoni gjerman si dhe kundra vendimeve te njoftuna mbi shperngulien e popullsis gjermane, tue u perpjeke qe ket popullsi t'a çfrytezojne per qellime armiqesore kunder shteteve fqinje. Fushata e elementave revizjoniste gjerman asht e drejtueme sidomos kundra kufinit polono-gjerman mbi Oder dhe mbi Nisen prendimore, i cili asht kufi i pandryshueshem-kufi paqe. Konferenca e Londres e ka lane ne heshtje çashtjen e fushates revizioniste tue i nxite ne ket menyre tendencat agresive te qarqeve reakcjonare gjermane. Ne keto kushte zbatimi i masave kundra çdo veprimtarije revizjoniste asht nji nga kushtet ma te randesishme per forcimin e paqes dhe per sigurimin e popujve europjane.

4) Vendimet e Konferences se tri shteteve ne Londer ua nenshtrojne ekonomin e Gjermanis prendimore qellimeve te SH. B. A. dhe Britanis se Madhe, tue e lidhe kryekeput me zbatimin e t'ashtu quejtunit „plan Marshall" n'Europe. Kjo don te thote se industrija dhe deget tjera t'ekonomis se Gjermanis prendimore do te pengohen nga planet e monopoleve kapitaliste amerikane dhe britanike, te cilet synojne me e nenshtrue te tane jeten ekonomike te zonave prendimore te Gjermanis dhe nuk jane aspak t'interesuem per rindertimin dhe ngritjen e vertete t'industris paqesore te Gjermanis, ne te cilen ata shofin konkurentin e vet. Kjo politike ekspansjoniste ka per qellim forcimin e mututjeshem te mvaresis se vendeve qe jane te lidhuna me „planin Marshall" dhe per forcimin e monopoleve amerikane e britanike. Rindertimi dhe zhvillimi i industris paqesore gjermane jo vetem se nuk asht ne kundershtim me interesat e popujve tjere, por edhe u pergjigjet detyrave te rindertimit ekonomik t'Europes. Popullit gjerman duhet me i dhane mundesina te gjana ne rindertimin dhe zhvillimin e industris paqesore, bujqesis dhe transportit si dhe te tregetis se jashtme, sepse pa ket Gjermanija nuk mund t'egzistoje dhe t'i plotsoje detyrimet e saja te damshperblimeve ndaj vendeve te damtueme nga agresjoni gjerman. Ne lidhje me ket, gjat periudhes se caktueme duhet te mbahet pa tjeter kontrolli i kater shteteve per te mos u-lejue pertrimja e industris luftarake gjermane dhe e militarizmit gjerman. Perfshimja e ekonomis se zonave prendimore te Gjermanis ne planin e Marshallit don te thote qe edhe ne ket pjese te Gjermanis te shtrihet plani i perçamjes se mbare Europes ne dy kampe, e cila perçamje po zbatohet simbas planit Marshall-ne kampin e shteteve europjane qe e kane pranue planin Marshall dhe ne saje te cilit i jane nenshtrue kontrollit te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, nga nji ane dhe shteteve europjane, ne te cilat hyjne BRSS dhe republikat e demokracis popullore, te cilat nuk mund te lejojne perziemjen e jashtme ne punet e tyne te mbrendeshme, nga ana tjeter.

Ne ket menyre Konferenca e Londres jo vetem e ka perfundue definitivisht zbatimin e planit per perçamjen dhe coptimin e Gjermanis, por, krahas me ket ne pajtim me planin Marshal, e thellon edhe ma teper perçamjen ndermjet shteteve t'Europes ne dy kampe te kunderta. Asht e kuptueshme se realizimi i politikes se ketille nuk ka kurrgja te perbashket me interesat e vertete te popujve t'Europes me rindertimin ekonomik t'Europes.

Nuk duhet theksue se zbatimi i kesaj politike te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe e Frances e ven ekonomin e zonave prendimore te Gjermanis ne kushte te padurueshme te nenshtrimit planeve ekspansjoniste te kapitalit te jashtem, i cili nuk e çane aspak krye per interesat e Gjermanis demokratike.

5) Konferenca e Londres ka marre vendimin special mbi çashtjen e Rurit. Asht vendose te formohet organi i posaçem per kontroll'in e shperndamjes se qymyrit, koksit e çelikut te Rurit, organ i perbame prej perfaqesuesave te shteteve pjesemarrse ne konferencen e Londres tue perjashtue nga ky kontroll prodhimin e qymyrit, koksit dhe çelikut, me te cilin sigurohet ruejtja e pozites dominuese te monopoleve financjare e industrijale amerikane dhe britanike n'industrin e Rurit.

Ne ket menyre, ne vend qe trustet e kartelat e qymyrit ne Rur si dhe trustet dhe kartelat metalurgjike t'i dorezohen popullit gjerman si prone e tija, per te cilen gja insistojne si Bashkimi Sovjetik ashtu edhe pjesemarrsat tjere ne ket konsulte, qeverinat e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes dhe Britanis se Madhe ne realitet e lane industrin e rande te Rurit ne duer te tyne, pa pjesmarrjen e Frances dhe Bashkimit Sovjetik dhe pa kurrfare influence t'organizatave demokratike gjermane ne kontrollin mbi prodhimin e saje.

Keshtu lehtesohet mundesija e ujdisjes ndermjet monopoleve amerikane dhe britanike, nga nji ane, dhe magnateve gjermane t'industris se qymyrit dhe çelikut te Rurit, nga ana tjeter çka krijon mundesin per rimekambjen e potencjalit luftarak te Gjermanis dhe krijimin e vatrave t'agresjonit te ri gjerman. Nuk asht veshtire me kuptue se politika e ketille nuk asht kursesi ne pajtim me interesat e paqes, interesat e popullit gjerman dhe popujve te tjere t'Europes. Vetem dorzimi i industris se rande te Rurit ne duer te popullit gjerman dhe vomja e kontrollit mbi prodhimin dhe shperndamjen e prodhimit t'industris se Rurit, per nji afat te caktuem, nga ana e kater shteteve — Bashkimit Sovjetik, Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se Madhe dhe Frances — te cilat mund t'a sigurojne bashkarisht zhvillimin e industris se Rurit vetem e vetem per qellime paqesore, do t'a sigurojshin mundesin qe çashtja e Rurit te zgjidhet n'interes te paqes dhe sigurimit te popujve europjane.

6) Nga sa ma nalte shihet se vendimet e Londres jane nji shkelje brutale e marreveshtjeve te Jaltes e Potsdamit mbi unitetin e Gjermanis dhe mbi zbatimin e demilitarizimit, denazifikimit dhe demokratizimit te Gjermanis, mbi asgjasimin e potencjalit ushtarak te Gjermanis dhe likuidimin e kushteve te cilat do te mund t'a lehtesojshin agresjonin e ri gjerman.

Ne lidhje me ket duhet me i konsiderue krejt te pathemelta thanjet e komunikates se Londres se vendimet e Londres duhet t'a lehtesojne arritjen e marreveshtjes ne t'ardhmen ndermjet kater shteteve mbi çashtjen e Gjermanis. Pathemeltesija e thanjeve te tilla shihet edhe nga fakti qe vendimet e Londres jane ne kundershtim te plote me vendimet e aprovueme ne Konferencen e Jaltes dhe te Potsdamit dhe qe shkelin edhe marreveshtjen mbi zbatimin e mekanizmit katersh te kontrollit per Gjermanin dhe marreveshtjen mbi shqyrtimin e çashtjes gjermane ne Keshillin e ministrave te punve te jashtme me pjesemarrjen e kater shteteve.

Konsultimet separatiste te tri shteteve ne Londer me pjesemarrjen e Beneluksit dhe vendimet separatiste te ketyne shteteve, te marruna ne Londer jo vetem se nuk mujne me e lehtesue mbrritjen e marreveshtjes ne mes te kater shteteve mbi çashtjen e Gjermanis, por edhe e minojne besimin e popujve ndaj marreveshtjeve nderkombetare ne te cilat marrin pjese Shtetet e Bashkueme t'Amerikes dhe Britanija e Madhe. S'asht veshtire me kuptue se shkelja e marreveshtjeve t'arrijtuna nderkombetare nuk mundet me ngjalle besim ndaj shkelsave te ketyne marreveshtjeve.

Tue marre parasysh sa ma nalte refuzojme me i konsiderue te pluftshme vendimet e Konferences se Londres dhe nuk ua njofim kurrfare autoriteti moral.

7) Ne pajtim me marreveshtjet e Jaltes dhe te Potsdamit mbi Gjermanin, qeverinat e Bashkimit Sovjetik, Shqipnis, Bullgaris, Çekosllovakis, Jugosllavis, Polonis, Rumanis e Hungaris e konsiderojne si urgjente, para se gjithash zgjidhjen, e ketyne çashtjeve:

E para: zbatimin e masave qe sigurojne perfundimin e demilitarizimit te Gjermanis, ne pajtim me marreveshtjen ndermjet Britanis se Madhe, Bashkimit Sovjetik, Frances dhe Shteteve te Bashkueme t'Amerikes.

E dyta: vendosjen per nji afat te caktuem, te kontrollit te kater shteteve — Britanis se Madhe, Bashkimit Sovjetik, Frances e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes — mbi industrin e rande te Rurit me qellim zhvillimi t'industris paqesore te Rurit dhe ndalimi te pertrimjes se potencjalit luftarak te Gjermanis.

E treta: formimin — ne pajtim me marreveshtjen ndermjet qeverinave te Britanis se Madhe, Bashkimit Sovjetik, Frances e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes — e qeveris se perkohshme te perbashket demokratike paqedashese gjermane, te perbame prej perfaqesuesave te partive dhe organizatave demokratike te Gjermanis — me qellim garancije se nuk do te perseritet agresjoni gjerman.

E katerta: lidhjen e traktatit te paqes me Gjermanin ne pajtim me vendimet e Potsdamit, me kusht qe trupat okupuese te te gjitha shteteve te terhiqen nga Gjermanija nji vjet mbas nenshkrimit te traktatit te paqes.

E pesta: marrjen e masave per kryemjen e detyrimeve te Gjermanis per pagimin e damshperblimevet shteteve qe jane damtue nga agresjoni gjerman.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Shtypshkroja Krahinore e Frontit Populluer Pajtimet ne fletore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.